



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sporte, Inovacion dhe Ndërmarrësi

Mbledhja nr.03

Prishtinë, më 24.10.2017, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Ismajl Kurteshi, kryetar, Teuta Haxhiu, Mufera Shinik, Arbërie Nagavci, Adem Mikullovc, Fidan Rekaliu, Abdyl Salihu, Nezir Çoçaj, dhe Albulena Balaj-Halimaj, anëtarë.

Munguan: Valentina Bunjaku-Rexhepi dhe Verica Qeraniq.

Përfaqësues të ftuar: Besim Beqaj, ministër i MIN-së.

Përfaqësues të tjerë: Artan Murati-KDI dhe përfaqësues të medias.

Stafi mbështetës i komisionit: Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

Mbledhjen e kryesoi, Ismajl Kurteshi, kryetar i komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 17.10.2017;
3. Diskutim lidhur me programin legjislativ dhe prioritetet e Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, i ftuar z. Besim Beqaj, ministër i MIN-së;
4. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 17.10.2017

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më datë 17.10.2017, u miratua pa vërejtje.

3. Diskutim lidhur me programin legjislativ dhe prioritetet e Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë (MIN)

Kryetari i komisionit, në fillim të mbledhjes, tha se komisioni ka ftuar ministrin Besim Beqaj, me qëllim të informimit nga ministri për fushat që i mbulon, rreth programit dhe prioritetëve të kësaj ministrie. Fjala iu dha ministrit të MIN-së.

Ministri Besim Beqaj, në fillim të diskutimit të tij, tha se kompetencat dhe fushëveprimi i Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, janë përcaktuar në mbledhjen e tetë të Qeverisë së Republikës së Kosovës, më datë 13 tetor 2017. Mbi bazën e këtyre kompetencave do të hartohet plani i punës dhe prioritetet e ministrisë. Sa i përket programit legjislativ, ministri Beqaj tha se fillimisht do të përgatisë Strategjinë për inovacion dhe ndërmarrësi, nga ku do të rrjedhë Ligji për inovacion dhe ndërmarrësi. Kurse, sa i përket prioritetëve të Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, tha se ka për synim stimulimin e aktiviteteve inovative në Republikën e Kosovës, të cilat do të jenë të lidhura ngushtë me ndërmarrësinë dhe fushat tjera të ekonomisë.

Lidhur me kompetencat e ministrisë, tha se do të bëhet koordinimi ndërqeveritar për zhvillimin e ndërmarrësisë dhe inovacionit, përmes trupave koordinues në mes të Qeverisë së Kosovës dhe sektorit privat për inovacion dhe ndërmarrësi. Po ashtu, në bashkëpunim me komunitetin e biznesit, identifikon, përkrah dhe ofron trajnime profesionale për ndërmarrësit dhe ndërton një sistem gjithëpërfshirës për mbështetje dhe zhvillim cilësor të ndërmarrësisë.

Teuta Haxhiu, tha se meqenëse ministria është në konsolidim e sipër, ne si komision do të përkrahim punën e saj. Pra, jemi për bashkëpunim dhe transparencë dhe do të angazhohemi në monitorimin e punës në këtë ministri. Në vazhdim, kërkoi sqarim nga ministri lidhur me funksionimin e Qendrës së Inovacionit në Gjakovë.

Arbërie Nagavci, kërkoi sqarim lidhur me kompetencat dhe koordinimin e ministrisë me ministritë tjera për sa i përket trajnimeve dhe aftësimeve profesionale, duke pasur parasysh se në kuadër të MASHT, ekziston Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional, si do të bëhet ndarja e përgjegjësisë. Sa i përket buxhetit për ministrinë, kërkoi sqarim lidhur me kërkesat për ndarjet buxhetore.

Nezir Çoçaj, tha se lidhur me kompetencat e ministrisë, të cilat u prezantuan para komisionit, mendon se vetëm njëra nga kompetencat e kësaj ministrie bie në fushëveprimin e komisionit. Kërkoi nga ministri që të bashkëpunojë me universitetet, si dhe shtroi pyetjen lidhur me rolin e Departamentit të Inovacionit, në fushën e kërkimeve shkencore.

Fidan Rekalju, theksoi se themelimi i kësaj ministrie dhe përcaktimi i kompetencave të saj, a nënkupton marrjen e kompetencave të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Ministrisë së Kulturës?

Mufera Sinik, tha se si komision do të bashkëpunojmë me ministrinë në të gjitha çështjet për të përmbushur misionin e saj.

Adem Mikullovci, kërkoi sqarim nga ministri se në kuadër të inovacionit, a përfshihet edhe digjitalizimi i RTK-së, përfshirë digjitalizimin e fotografisë, zërimin etj.

Albulena Balaj- Halimaj, tha se duke pasur parasysh fushëveprimtarinë dhe kompetencat e kësaj ministrie, kjo ministri nuk do duhej të përfshihej në kuadër të komisionit për Arsim, përkundër kësaj bashkëpunimi nuk do të mungojë. Në vazhdim, kërkoi sqarim nga ministri lidhur me kompetencën që ndërlidhet me propozimin e politikave për rregullimin e tregut të brendshëm për inovacion dhe ndërmarrësi, masave fiskale dhe jofiskale në funksion të zhvillimit të sektorëve të inovacionit dhe ndërmarrësisë.

Ismajl Kurteshi, ngriti çështjen e themelimit të kësaj ministrie dhe kompetencave të saj, duke pasur parasysh se caktimi i veprimtarisë është bërë pas aktit të themelimit të saj. Çështja tjetër ka të bëjë me fondin prej 10 milionë eurosh për përkrahje të ndërmarrjeve private. Si do të caktohen kriteret dhe shuma për ndarjen e këtij fondi?

Ministri Beqaj, iu përgjigj anëtarëve të komisionit në çështjet e ngritura, si dhe shprehu gatishmërinë për të bashkëpunuar me komisionin për synimet e përbashkëta, në funksion të interesit publik. Ai theksoi se ministria është e re, dhe sipas tij, ajo do të merret me çështjen e inovacionit dhe ndërmarrësisë, duke pasur prioritet të rinjtë dhe të rejtat, do të përkrahen në forma të ndryshme nëpërmjet programit, të cilin kjo ministri është duke e hartuar. Ekonomia jonë ka nevojë për njerëz të përgatitur lidhur me plan-programet e ekonomisë, po ashtu do të ketë trajnime profesionale.

4. Të ndryshme

Në këtë pikë të rendit të ditës nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 13:35.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetari i komisionit,

Ismajl Kurteshi